



Republika e Kosovës  
Republika Kosova • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 1102/2019  
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 28/06/2019



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

### MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS LIDHUR ME VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE NË DUBRAVË

- Për:
- Z. Abelard Tahiri, Ministër  
Ministria e Drejtësisë
- Z. Uran Ismaili, Ministër  
Ministria e Shëndetësisë
- Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm  
Shërbimi Korrektues i Kosovës
- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor  
Departamenti Shëndetësor në Burgje
- Z. Rashit Qalaj, Drejtor i Përgjithshëm  
Policia e Kosovës
- Znj. Miradije Kelmendi, Kryeshefe Ekzekutive  
Inspektorati Policor i Kosovës
- Z. Ilir Kelmendi, U.d. Drejtor  
Qendra Korrektuese në Dubravë

Prishtinë, më 28 qershor 2019

## HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit vizitoi Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejmë *MKPT*), bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, qëndrimi i të cilëve në Republikën e Kosovës bie ndesh me ligjet në fuqi dhe të cilët janë subjekt i kthimit me forcë nga Republika e Kosovës, si dhe institucionet psikiatrike dhe ato të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, nga data 27 shkurt 2019 deri më 1 mars 2019, e ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (në tekstin e mëtejmë *QKD*).

Objktivi i kësaj vizite ishte vlerësimi i zbatimit të rekondimeve të MKPT-së, të cilat u ishin dërguar autoriteteve kompetente përmes Raportit me rekondime për vizitën në QKD, e cila ishte realizuar nga data 20 deri më 22 mars 2018.<sup>1</sup> Përveç kësaj, qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të personave të dënuar, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Gjatë vizitës është trajtuar edhe çështja e procedurave të pranimit, njohja e të burgosurve me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e akomodimit, regjimi, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet të të burgosurve, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore, të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe mënyra e ekzekutimit të tyre.

### Përbërja e grupit monitorues

1. Ekipi monitorues përbëhet si në vijim:

- Drejtoresha e MKPT-së
- Këshilltari i lartë juridik për parandalim të torturës
- Dy këshilltarë juridikë për parandalim të torturës
- Këshilltarja-mjeke
- Këshilltarja-psikologe
- Këshilltarja-punëtore sociale

### Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës së MKPT-së të realizuar në QKD, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (në tekstin e mëtejmë DShB) i kanë

<sup>1</sup> Raport me rekondime nga vizita në QKD, publikuar më 24 gusht 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/08/30/raport-me-rekondime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-avokati-i-popullit-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>.

ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit i janë siguruar të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe i janë mundësuar bisedat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër. Përveç kësaj, ekipi, në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, ka përdorur fotoaparatin pa u penguar fare nga autoritetet e QKD-së.

### **Keqtrajtimi fizik**

3. Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. MKPT-ja ka vërejtur se niveli i komunikimit interaktiv ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të të burgosurve ishte në nivel të kënaqshëm.
4. Ekipi monitorues, gjatë intervistimit të të burgosurve, është interesuar për trajtimin e tyre nga policia e Kosovës dhe për respektimin e të drejtave të tyre themelore, që nga momenti i arrestimit. Shumica dërmuese e të intervistuarve kanë pohuar se janë trajtuar në mënyrë korrekte nga policia e Kosovës dhe se të drejtat e tyre themelore janë respektuar.
5. Megjithatë, MKPT-ja ka pranuar një ankesë nga i burgosuri E. Xh., me pretendimin se është keqtrajtuar fizikisht nga zyrtarët e Policisë së Kosovës, në kohën kur është arrestuar dhe është dërguar në stacionin policor ku edhe është intervistuar. I burgosuri ka pohuar se ai është arrestuar më 24 shkurt 2019. Sipas pohimeve të ankuesit, gjatë arrestimit dhe pas dërgimit në Stacionin Policor nr. 4, ai është keqtrajtuar fizikisht dhe është fyer verbalisht me fjalë të ndryshme. MKPT-ja ka vërejtur shenja të lëndimeve trupore tek i burgosuri (hematomë në sy, gjurmë të goditjeve në pjesë të ndryshme të shpinës), të cilat janë regjistruar përmes fotoaparatit.
6. MKPT-ja, pas shqyrtimit të dhënave të grumbulluara, përfshirë edhe analizën e dosjes mjekësore të të burgosurit, çështjen në fjalë ia ka kaluar Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) për hetim të mëtejmë. MKPT-ja po ashtu kërkon nga IPK-ja ta njoftojë këtë mekanizëm me rezultatin e hetimeve pas përbillyjes të tyre.
7. MKPT-ja rithekson se të gjithë zyrtarëve të Policisë së Kosovës duhet t'u bëhet e qartë se të gjitha format e keqtrajtimit fizik të personave të arrestuar janë të papranueshme dhe se do t'u nënshtrohen sanksioneve ligjore të gjithë zyrtarët policorë, të cilët kryejnë veprime të tillë. Zyrtarëve policorë duhet t'u bëhet me dije se nuk mund të përdorin forcë më shumë se që është e domosdoshme kur realizojnë një arrestim dhe se në momentin që i arrestuari futet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për përdorim të forcës fizike.
8. Ekipi monitorues po ashtu ka vizituar edhe të burgosurit, të cilëve u është shqiptuar masa disiplinore e vetmisë dhe të cilët ishin të vendosur në qeli të caktuara. MKPT-ja nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik, për përdorim të tepruar të forcës apo për shkelje të të drejtave tjera të cilat u takojnë personave në fjalë.

## Miratimi i legjisacionit sekondar për eliminimin të korruptionit

9. Sa i përket rekomandimit të MKPT-së lidhur me miratimin e legjisacionit sekondar për eliminimin të korruptionit, siç parashihet me nenin 5, paragrafi 3, të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, MKPT-ja konstaton se situata mbetet e njëjtë dhe se autoritetet kompetente nuk e kanë implementuar këtë rekomandim.

### Kushtet materiale

#### Ushqimi

10. MKPT-ja ka vërejtur se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe të fuqisë së tij në tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojullojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës e kushteve klimatike dhe, për aq sa është e mundur, duhet t'i përshtatet kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Më tej, ligji përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.<sup>2</sup> Po ashtu, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e të burgosurit që gjatë gjithë kohës të ketë në dispozicion ujë të pijshëm.<sup>3</sup> Sipas Drejtorisë, uji të cilin e përdorin të burgosurit është i pijshëm.
11. MKPT vëren se edhe Rregullat e Mandelës përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim adekuat për shëndetin e tyre, si dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë kohës.<sup>4</sup> Në këtë drejtim, Rregullat Evropiane të Burgjeve përcaktojnë obligimin e autoriteteve që të burgosurve t'u sigurojnë ushqim dietal, duke pasur parasysh moshën e tyre, gjendjen e tyre fizike, religionin dhe natyrën e punës së tyre. Ndërsa ushqimi duhet të përgatitet dhe të shërbehet në kushte adekuate higjenike, kurse uji i pijshëm duhet të jetë në dispozicion gjatë gjithë kohës.<sup>5</sup>
12. MKPT-ja ka vërejtur se QKD-ja tani për të burgosurit ofron ushqim dietal sipas rekomandimeve të mjekut, megjithëse jo gjithmonë, për shkak të problemeve të kohëpaskohshme. Ushqimi shërbehet në sasi të mjaftueshme, por nuk është cilësor (përmban shumë yndyrë, nuk ka shije dhe mishi është me erë të rëndë). Ndërsa uji i pijshëm është në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës.
13. Në përgjithësi, gjatë kësaj vizite përcjellëse në QKD, MKPT-ja ka marrë numër dukshëm më të vogël të ankesave lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit që u shërbehet të burgosurve, krahasuar me vizitën e realizuar në mars të vitit 2018.

#### Kuzhina

14. MKPT-ja konsideron se gjendja në kuzhinë, lokacioni, pastërtia, madhësia, infrastruktura dhe numri i personelit, i cili punon në kuzhinë, janë elemente të cilat në përgjithësi reflektojnë kushtet e përgjithshme në burg.

<sup>2</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

<sup>3</sup> Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 40.

<sup>4</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 22.

<sup>5</sup> Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregullat 22.1 deri 22.6.

15. MKPT-ja ka vërejtur se janë të angazhuar në punë 6 kuzhinierë, shefi i kuzhinës, një furrtar, një depoist, 34 të burgosur të angazhuar në punë tjera ndihmëse në kuzhinë, 12 të burgosur të angazhuar në furrë (pjekje buke) dhe 3 për mbajtje të higjenës në kuzhinë.
16. Të angazhuarit në punë, përfshirë këtu edhe të burgosurit, janë të pajisur me libreza adekuate sanitare, të cilat janë valide. MKPT-ja ka vërejtur se depoja ku mbahet ushqimi afatgjatë ishte në gjendje të mirë dhe i ka kushtet që nevojiten për ruajtje të ushqimit dhe nuk ka lagështi. Gjatë vizitës është vërejtur se ende ka mungesë të uniformave, mungesë të mbathjeve adekuate, si dhe mungesë të dorëzave për punë.
17. Është vërejtur se as stafi e as të burgosurit nuk kanë veshje adekuate të punës për kuzhinë (përdorin qese bërlloku si përparëse ose për mbathje në këmbë, për të mos u lagur nga uji gjatë larjes së enëve apo kryerjes së punëve në kuzhinë). Kuzhina ishte e furnizuar me tharëse duarsh të cilësisë së dobët, me sapun të lëngët të cilësisë së dobët dhe që në përgjithësi ndikon negativisht në mbajtjen e higjenës së personelit gjatë punës në kuzhinë.
18. MKPT-ja është njoftuar se ka mungesë të mbulesave të tavolinave për ushqim (janë të vjetruara, të dëmtuara dhe nuk pastroheshin mirë). Vendi ku duhet t'i pastrojnë duart të burgosurit para se të ulen për t'u ushqyer nuk ishte i furnizuar me sapun dhe tharëse, ndërsa lavamani ishte i bllokuar me mbetje ushqimi, kurse pajisjet tjera ishin me disa defekte teknike. Po ashtu, vazhdon të ketë mungesë të enëve speciale që dedikohen për bartjen e ushqimit në pavijone dhe për ta mbajtur të ngrohtë ushqimin.
19. MKPT-ja ka vërejtur se në sallën e ushqimit janë duke u rregulluar tavolinat për ta mundësuar mirëmbajtjen higjenike të dyshemesë. Po ashtu, janë bërë disa investime në inventarë për përgatitje të ushqimit.
20. Lidhur me orarin e shpërndarjes së ushqimit, gjatë vizitës përcjellëse, MKPT-ja ka marrë ankesa shumë të rralla. MKPT-ja e konsideron shqetësuese informatën se kontejnerët me mbeturina largohen pas 2-3 ditësh dhe aty grumbullohen qentë endacakë dhe mbeturinat ishin shpërndarë nëpër oborrin pas kuzhinës.
21. Furnizimi me mjete për gatim të bukës ishte i mirë, i rregullt dhe me afat, por jo edhe cilësor (probleme gjatë gatimit, për shkak të cilësisë së miellit). MKPT-ja ka vërejtur se disa nga pajisjet janë të rregulluara dhe tani pastrimi është më i mirë.
22. MKPT-ja ka vërejtur se në hapësirën që përdoret për lavanteri nuk ka asnë ndryshim apo renovim, por mbetet me të njëjtat probleme, edhe më të rënduara. Po ashtu, nuk kishte dritë natyrore, ishte pa ajrosje, kishte lagështi, erë të rëndë nga përdorimi i mjeteve të ndryshme kimike, të cilat nuk janë adekuate për pastrim. Po ashtu, personat që punojnë në lavanteri nuk kanë rroba pune, maska e as ushqim adekuat për kushtet në të cilat punojnë, përpos qumështit, si shtesë në racion ditor.

### Kushtet e akomodimit

23. Kushtet e akomodimit dallojnë nga pavijoni në pavijon. Gjatë vizitës së realizuar nga MKPT-ja, në renovim e sipër ishin pavijonet 4 dhe 6. Gjatë vizitës ad-hoc, e realizuar më 3 maj 2019, MKPT-ja konstatoi se renovimet në këto pavijone kanë përfunduar dhe se

të burgosurit janë vendosur në to. Renovime të caktuara janë kryer edhe në spitalin e burgut, gjë që ishte edhe rekomandim i MKPT-së përmes Raportit me rekomandime lidhur me vizitën në vitin 2016 dhe në vitin 2018. Qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm dhe ventilim.

24. Gjatë vizitës, MKPT-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë të burgosurve, të cilëve u ishte shqiptuar masa e vetmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore. MKPT-ja ka vërejtur se Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se dhoma për ekzekutimin e masës disiplinore të vetmisë duhet të ketë një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metrash kub, pajisje sanitare, dritë natyrore, ujë të pijshëm, shtrat me çarçaf, tavolinë, karrige dhe ngrohje.<sup>6</sup>
25. Po ashtu, Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejmë *KPT*), lidhur me kushtet e akomodimit në qeli ku mbahet i burgosuri, të cilit i shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, thekson se qelitë e tillë duhet t'i plotësojnë standarde minimale, si ato të cilat zbatohen në rastet e vendosjes së të burgosurve të tjera. Ato duhet të janë të madhësisë adekuate, të kenë dritë natyrore, të kenë ngrohje adekuate dhe të kenë ventilim. KPT-ja më tej thekson se qelitë e tillë duhet të janë së paku të pajisura me tavolinë, me karrige adekuate, me krevat adekuat dhe me çarçaf.<sup>7</sup>
26. MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e vendosjes në këto qeli tani janë dukshëm më të mira sesa ato që ishin gjetur gjatë vizitës në mars të vitit 2018 dhe i plotësojnë standarde përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe me standarde përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës.<sup>8</sup> Prandaj, MKPT-ja mirëpret zbatimin e rekomandimit të saj dërguar autoriteteve kompetente përmes Raportit me rekomandime për vizitën në QKD, në mars të vitit 2018, lidhur me kushtet e vendosjes në qelitë ku vendosen të burgosurit të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë.
27. MKPT-ja ka vërejtur se në pavijonin 8 nuk ka pasur renovime ashtu siç kishte rekomanduar MKPT-ja përmes Raportit me rekomandime për vizitën në QKD, e realizuar në mars të vitit 2018. MKPT-ja ka vërejtur se në këtë pavijon, në njërin krah, ka depërtuar pjesërisht lagështia, ndërsa radiatorët pikonin si pasojë e defekteve teknike dhe, në këtë mënyrë, ngrohja nuk ishte në nivel të duhur.
28. Gjatë vizitës, sërisht është vërejtur se të burgosurit përdorin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit, të cilat mund t'i rrezikojnë seriozisht jetët e tyre. Sipas pohimeve të të burgosurve, në mungesë të ujit të ngrohtë, ata detyrohen të përdorin pajisje të tillë të improvizuara. MKPT-ja konstaton se nuk është zbatuar rekomandimi që kërkonte ndërmarrjen e hapave konkretë, në mënyrë që të ndërpritet praktika e përdorimit të pajisjeve të improvizuara elektrike.

<sup>6</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 111, paragrafi 2.

<sup>7</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga raporti i 21-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2011, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>, (21.5.2018).

<sup>8</sup> Standarde KPT-së lidhur me kushtet e akomodimit për të burgosurit të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë janë përcaktuar përmes raportit të 21-të të Përgjithshëm. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>.

29. MKPT-ja ka vërejtur se edhe Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, gjatë vizitës në Kosovë në vitin 2015, kishte shprehur shqetësimin për përdorimin e pajisjeve elektrike të improvizuara nga të burgosurit në QKD dhe kishte kërkuar nga autoritetet relevante të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin hapa konkretë për evitimin e përdorimit të pajisjeve të tilla.<sup>9</sup>
30. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja është njoftuar nga të burgosurit, në të gjitha pavijonet, se atyre nuk u jepen çarçafë dhe se ata duhet t'i sjellin nga familjet e tyre, kurse batanijet u jepen nga QKD-ja.<sup>10</sup> MKPT-ja konsideron se autoritetet relevante duhet të veprojnë në pajtim me obligimet, të cilat burojnë nga nen 16 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.
31. MKPT-ja ka vërejtur se të burgosurit edhe më tej, po thua jse në të gjitha pavijonet, detyrohen t'i mbajnë gjësendet e tyre në qese plastike apo në pako të kartonit, meqenëse hapësirat që i kanë në dispozicion nuk u mjaftojnë. MKPT-ja konstaton se nuk është zbatuar rekomandimi që të burgosurit të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjësendeve të tyre.
32. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në pavijonin numër 7 janë dy dhoma që shfrytëzohen përkohësisht nga shërbimi shëndetësor. Në këto dhoma ishin të vendosur pacientët e klasifikuar, që si pacientë, më lehtë për t'u menaxhuar, por, pa ndarje sipas natyrës së sëmundjes. Shëtitorja ishte e vogël dhe jo e mjaftueshme për të zhvilluar aktivitete të jashtme fizike. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se dhomat mirëmbahen dhe pastrohen nga vetë pacientët, gjë që nuk është praktikë e mirë.
33. Sa i përket mirëmbajtjes së dhomave nga vetë pacientët, MKPT-ja ka vërejtur se edhe KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, e kishte kritikuar një praktikë të tillë dhe kishte kërkuar që praktika e tillë të ndërpritet menjëherë, duke konsideruar se puna e tillë për të mirëmbajtur dhomën është shumë e papërshtatshme për të burgosurit, të cilët janë të sëmurë.<sup>11</sup>

### Regjimi

34. Sa i përket regjimit, në QKD, sipas Drejtorisë, janë rreth 300 të dënuar të angazhuar në punë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Zakonisht të dënuarit angazhohen për punë në kuzhinë, për pastrim dhe në ferma të QKD-së. Në kuadër të QKD-së funksionon edhe shkolla e mesme, në të cilën mësimin e vijojnë 28 nxënës. Të dënuarit mund të lëviznin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë

<sup>9</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 38. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

<sup>10</sup> Neni 16 i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese: “*Secili person i dënuar e ka shtratin e vetë, që përbëhet prej krevatit ose shtratit të posaçëm, dyshekun, jastëkun me këllëfin, dy çarçafë dhe një ose dy plafa së verës respektivisht dy (2) deri në tre (3) plafa gjatë periudhës së dimrit, varësisht nga ngrohja. Secili person i dënuar ngarkohet me shtratin e vet, me sendet që e përbëjnë shtratin dhe me dollapin për sendet personale.*”

<sup>11</sup> Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, publikuar në shtator 2016, paragrafi 61, shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

për 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit deri në 2 orë në ditë.<sup>12</sup> Megjithatë, nga intervistat me të burgosurit, del se atyre u lejohet shëtitje dy herë në ditë, me kohëzgjatje prej 45 minutash. MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet ta respektojnë të drejtën e të burgosurve për shëtitje gjatë stinës së dimrit, e cila është e garantuar me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe duhet të bëhet dy herë në ditë nga një orë.

35. Gjithashtu, në kuadër të QKD-së funksionojnë tri punëtori, të cilat në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, për ndërtimtari, për axhustator, për zdrukthëtar, për mirëmbajtje teknike, për instalim të ujit dhe për instalim të rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse, me kohëzgjatje prej tre muajsh. MKPT-ja është njoftuar se, tash për tash, nuk ka trajnime, për shkak të motit, pasi që në punëtori nuk ka ngrohje. MKPT-ja konsideron se aktivizimi i trajnimeve në punëtori është i rëndësishëm për rehabilitimin e të burgosurve dhe për ofrimin e aktivitetave të mirëfillta jashtë qelisë.
36. Gjatë vizitës ad-hoc, e realizuar më 3 maj 2019, MKPT-ja u njoftua nga Drejtoria e QKD-së se organizata ndërkombëtare HELP do të sigurojë pajisje dhe trajnim për saldim për 10 të burgosur.
37. Në kuadër të QKD-së, në dispozicion të të burgosurve është salla e fitnesit dhe fusha e futbollit. Të burgosurit mund të bëjnë fitnes dy herë në javë nga 45 minuta, ndërsa fushën e futbollit mund ta shfrytëzojnë një herë ose dy herë në javë nga 45 minuta, varësisht nga regjimi të cilit i nënshtrohen të burgosuri. Të burgosurit e vendosur në pavjonin D merren me aktivitete sportive, të cilat mund të zhvillohen në fushën sportive të pavjonit në kuadër të kohës së shëtitjes, e cilat zgjat 45 minuta dhe nuk kanë kohë të dedikuar për aktivitete sportive.
38. Gjatë vizitës ad-hoc, realizuar më 3 maj 2019, MKPT-ja u njoftua se ky pavjon tani është i mbyllur dhe se të burgosurit janë transferuar në pavjonet e rinovuara.
39. Salla e basketballit ende nuk përdoret, meqenëse duhet të ndërrohen xhamat e dëmtuar dhe të vendosen rrjeta, të cilat do t'i parandalonin dëmtimet e xhamave, që shkaktohen si pasojë e goditjeve me top. Prandaj, gjendja në këto objekte mbetet e njëjtë sikurse gjatë vizitës së realizuar në nëntor të vitit 2016 dhe në mars të vitit 2018. Rrjetdhimisht, MKPT-ja konstaton se rekomandimi për funksionalizimin e sallës së sportit nuk është implementuar.
40. Po ashtu, MKPT-ja u njoftua se ende nuk është funksionalizuar njësia ekonomike, e cila do ta shtonte angazhimin në punë të një numri më të madh të të dënuarve. Krijimi i njësive ekonomike parashihet edhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.<sup>13</sup> Përmes Raportit me rekomandime, pas vizitës së realizuar në mars të vitit 2018, MKPT-ja u ka rekomanduar autoritetet kompetente që të ndërmarrin veprime për funksionalizimin

<sup>12</sup> Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë për së paku dy orë shëtitje.

<sup>13</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 212-214.

e kësaj njësie ekonomike, e cila parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

### Kujdesi shëndetësor

41. Në Qendrën Korrektuese në Dubravë funksionon spitali i burgut, i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit, në të cilin janë angazhuar gjashtë mjekë të rregullt dhe një psikolog (një mjek është në dispozicion gjatë 24 orëve), njëzet e katër infermierë, nga të cilët gjashtë punojnë në ndërrime nga 12 orë, dy infermierë me orar 8-16, një farmacist i rregullt, një fizioterapeut i rregullt, një laborant, i cili kryen shpesh shërbime edhe në burgje tjera për analiza laboratorike.
42. Sipas nevojës dhe kërkesave të shërbimeve shëndetësore, aty ofrohen shërbime të ndryshme specialistike nga neurologu, psikiatri, radiologu (Eho, Rtg), kardiologu, pulmologu, infektologu, kirurgu, oftalmologu, ORL. Ndërsa urologu dhe ortopedi e kanë ndërprerë bashkëpunimin DShB-në. DShB-ja tani ka të angazhuar në këtë njësi shëndetësore një stomatolog të rregullt me orar të plotë, në pajtim me rekomandimin e MKPT-së. Prandaj, MKPT-ja konstaton se rekomandimi për të angazhuar një stomatolog të rregullt është zbatuar nga autoritetet kompetente.
43. MKPT në raportin e fundit për QKD<sup>14</sup>, të publikuar më 24 gusht 2018 e përshëndeti angazhimin e psikologut shtesë në QKD, mirëpo gjatë vizitës së fundit MKPT ka vërejtur se njëri psikolog është transferuar në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë. MKPT konsideron se numri i të burgosurve në QKD është tepër i madh për t'u mbuluar me shërbime psikologjike vetëm prej një psikologu. MKPT inkurajon DShB të bëjë zgjidhje për angazhimin e psikologut shtesë në QKD.
44. MKPT-ja, nga informatat e grumbulluara, ka vërejtur se personeli shëndetësor nuk është vaksinuar dhe mirëpret komentet e DShB-së në këtë aspekt.
45. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur se spitali, edhe pse ka pasur disa rinvime të dyshemeve të pjesës së stacionarit ku qëndrojnë pacientët, ende nuk i plotëson kushtet për trajtim adekuat të personave të hospitalizuar. Spitali është i ndarë në dy reparte: reparti psikiatrik dhe reparti i sëmundjeve organike. MKPT-ja ka vërejtur se dhomat janë të ngarkuara me pacientë, nuk ka klasifikim të tyre, sipas sëmundjes, në repartin psikiatrik dhe në atë të sëmundjeve organike, ose sipas numrit në dhoma apo të moshës, si dhe të atyre me aftësi të kufizuar. Shtretërit në dhomat e spitalit dhe mbulesat janë të vjetëruara dhe të papastras, dyshekët janë të vjetruar dhe jo higjenikë. MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka dollapë për mbajtje të rrobave apo të gjësendeve personale. Për më shumë, vihen re edhe mbetjet e ushqimit në dhoma.
46. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur se spitali edhe më tej nuk ofron zgjidhje adekuate për pacientët me aftësi të kufizuara për në katin e dytë, ku qëndrojnë të dënuarit me aftësi të kufizuara. Sipas Drejtorisë, një gjë e tillë do të bëhet gjatë këtij viti. MKPT-ja kërkon nga ShKK-ja që ta njoftojë këtë mekanizëm me risitë rreth kësaj çështjeje.

<sup>14</sup> Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/08/30/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-avokati-i-popullit-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>

## Rëndësia e kontrolleve mjekësore të të burgosurve të apo pranuar

47. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e kontrollimit mjekësor të të burgosurve të apo pranuar, veçanërisht në institucionet të cilat përbëjnë pikë hyrjeje në sistemin e burgjeve. Një kontrollim i tillë është esencial, veçanërisht për t'i parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve ngjitetëse (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).
48. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut mund të jepin kontribut domethënës në parandalimin e keqtrajtimit fizik gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe, kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.<sup>15</sup>
49. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>16</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimeve<sup>17</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin e autoriteteteve që i burgosuri i apo pranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.
50. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkontrollare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>18</sup>, Rregullat Evropiane të Burgjeve<sup>19</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>20</sup>
51. Bazuar në pohimet e të burgosurve dhe në dokumentacionin relevant mjekësor, të burgosurit e apo pranuar kontrolllohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në QKD. Këto kontolle nënkuqtojnë një kontroll të përgjithshme, sipas Praktikave Standarde të Veprimit të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve (PSV).

## Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

52. Bazuar në informatat nga stafi i shërbimit shëndetësor dhe nga intervistat me të burgosurit, shërbimet shëndetësore, në përgjithësi, jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues. Megjithatë, sipas informatave të grumbulluara nga MKPT-ja, në pavillonin D infermierja në detyrë i kryen shërbimet mjekësore ndaj të burgosurve vetëm në praninë e zyrtarëve korrektues dhe kurrsesi ndryshe. MKPT-ja mirëpret komentet e DShB-së lidhur me këtë çështje.
53. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,<sup>21</sup> e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me Ligjin për Ekzekutimin e

<sup>15</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

<sup>16</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 31.

<sup>17</sup> Praktika Standarde e Veprimeve, pika 1. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

<sup>18</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>19</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

<sup>20</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

<sup>21</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

Sanksioneve Penale,<sup>22</sup> me standardet e KPT-së,<sup>23</sup> si dhe me aktet ndërkombejtare, siç janë: Rregullat e Mnadelës<sup>24</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>25</sup>

54. Për më shumë, edhe standardet e KPT-së përcaktojnë se të gjitha ekzaminimet mjekësore të të burgosurve duhet të kryhen në atë mënyrë që të mos shihen dhe të mos dëgjohen nga zyrtarët korrektues, përveç në rastet kur mjeku e kërkon një gjë të tillë.
55. Neni 25, paragrafi 3, i Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese shprehimisht përcakton: “*Mjeku bënë vizitën mjekësore në kushte të konfidentialitetit mjekësor dhe normave etike profesionale.*”

#### Personeli i Qendrës Korrektuese në Dubravë

56. Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka marrë shqetësimë nga Drejtoria, për mungesë të personelit korrektues, të punëtorëve socialë dhe të psikologëve. Sipas Drejtorisë, momentalisht QKD-ja ka të angazhuar rrëth 60 zyrtarë korrektues për ruajtjen e personave me sëmundje kronike, të cilët janë të shtrirë në ente shëndetësore dhe një numër i zyrtarëve korrektues shkollohen në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri. Sipas Drejtorisë, afersisht 100 zyrtarë korrektues i mungojnë QKD-së. Sipas Drejtorisë, planifikohet shtimi i personelit korrektues edhe me 50 zyrtarë të rinj.
57. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka marrë shumë ankesa edhe nga personeli korrektues lidhur me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit dhe për kushtet tjera të punës. Një nga ankesat e shumta është edhe mosfurnizimi me uniforma dhe pajisje tjera të domosdoshme për ta kryer punën e tyre. MKPT-ja, gjatë intervistave me zyrtarët korrektues, ka marrë shqetësimet e tyre lidhur me Ligjin për Pagat, i cili së voni është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.
58. MKPT-ja sërisht thekson se mënyra se si personeli e percepton kualitetin e jetës në punë dhe mënyra se si ata trajtohen nga menaxherët dhe nga kolegët e tyre, ka një ndikim të rëndësishëm në atmosferën në burg dhe në trajtimin e të burgosurve. Zyrtarët korrektues, të cilët ndihen të çmuar, të besueshëm dhe të respektuar në vendin e tyre të punës, kanë gjasa më të mëdha që këto vlera t'i zbatojnë edhe në trajtimin e të burgosurve. Kushtet e favorshme të punës në burg po ashtu janë të rëndësishme për të térhequr dhe për të mbajtur personelin e duhur në burg.
59. Standardet ndërkombejtare në këtë aspekt janë të qarta dhe përcaktojnë se personeli në burgje duhet të emërohet me orar të plotë të punës, të kenë status civil, të kenë pagë adekuate dhe përfitime të favorshme të punësimit dhe kushte adekuate për ta kryer shërbimin e tyre. Pagat e vogla, kushtet joadekuante të punës dhe mungesa e përfitimeve tjera, të cilat janë të nevojshme për ta stimuluar punën adekuate në ambiente siç janë

<sup>22</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

<sup>23</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

<sup>24</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION\\_E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION_E_ebook.pdf).

<sup>25</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

burgjet, mund të kenë ndikim negativ në motivimin dhe në kryerjen e detyrave nga personeli i angazhuar për punë në burgje. Përveç kësaj, një situatë e tillë mund ta nxisë korruptionin.<sup>26</sup>

60. Gjithashtu, MKPT-ja sërisht ka marrë ankesa nga zyrtarët korrektues lidhur me çështjen e llogaritjes së stazhit të beneficuar. MKPT-ja ka vërejtur se nen 221 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: “*Zyrtarët korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dyshje (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i sigruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.*” MKPT-ja përsëri kërkon nga organet kompetente që për këtë çështje ta njoftojnë këtë mekanizëm.

### Shërbimi social në QKD

61. Gjatë vizitës në QKD, MKPT-ja është njoftuar se ende paraqet problem serioz numri i vogël i punëtorëve socialë krahasuar me numrin e të burgosurve. Sipas Drejtorisë, gjatë kësaj periudhe nuk kishte rekrutime të reja të punëtorëve socialë. MKPT-ja ka vërejtur se punëtorët socialë ndihen të stërngarkuar me punë administrative dhe shumë pak mund të angazhohen në rolin e tyre të mirëfilltë. Ata kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me situatën e tyre, bazuar në Ligjin për Pagat, stazhin e beneficuar dhe mospagimin e rrezikshmërisë. MKPT-ja konsideron se, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm, i cili u jepet shërbimeve sociale në burgje bazuar në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe me aktet tjera nënligjore, autoritetet kompetente duhet t'i adresojnë këto probleme me shumë seriozitet.

### Masat disiplinore

62. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe vetmia.<sup>27</sup> Kurse në rastin e të paraburgosurve, mund të shqiptohen dënimet si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo i korrespodencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike. Gjatë vizitës, me qëllim të analizimit të gjendjes në këtë aspekt, MKPT-ja ka analizuar disa vendime të Drejtorisë së QKD-së, me të cilat të burgosurve të caktuar u janë shqiptuar masa të ndryshme disiplinore, përfshirë edhe masën disiplinore të vetmisë.
63. MKPT-ja konstatoi se QKD-ja mban regjistër për masat e shqiptuara disiplinore, ku shënohen të dhëna lidhur me masën e shqiptuar, arsyen, kohën e shqiptimit dhe kohën e mbarimit. Po ashtu, këto vendime disiplinore u dorëzohen edhe të burgosurve dhe përmes të njëjtave ata njoftohen për mjetet juridike në dispozicion, në qoftë se janë të pakënaqur me masën disiplinore të shqiptuar. MKPT-ja, edhe gjatë kësaj vizite përcjellëse, nuk ka marrë asnjë ankesë nga të burgosurit e intervistuar, të cilët ishin në vetmi, lidhur me respektimin e të drejtave të tyre.

<sup>26</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 74. Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 79.1 dhe Rregulli 79.2. Raporti i 10-të dhe i 11-të i Përgjithshëm i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.

<sup>27</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

64. MKPT-ja është njoftuar se shërbimi mjekësor nuk merr pjesë në marrjen e vendimit lidhur me aftësinë e të paraburgosurit apo të dënuarit për ta përballuar masën disiplinore të vëtmisë. MKPT-ja konsideron se personeli mjekësor e ka të qartë rolin e tij në këtë aspekt. Pjesëmarrja e mjekut në vendimmarrje, i cili në fakt është mjeku i personit të paraburgosur apo të dënuar, do ta minonte raportin mjek-pacient, përvèç nëse kjo masë ndërmerret për arsyet e njëkësore.<sup>28</sup>

65. MKPT-ja, në raportet e mëhershme, ka shprehur shqetësimin përfaktin se legjislacioni në fuqi<sup>29</sup> parasheh që, para se i burgosuri të vendoset në vetmi, drejtori i institucionit korrektues të kërkojë me shkrim mendimin e mjekut, i cili dëshmon se i dënuari është në gjendje të mirë shëndetësore fizike dhe psikike për t’iu nënshtruar masës disiplinore të vëtmisë. MKPT-ja mirëpret heqjen e kësaj dispozite nga drafti i Ligjit përf Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili pritet të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. MKPT-ja do të vazhdojë ta monitorojë situatën sa i përket shqyrtimit në Kuvend të draft-ligjit në fjalë.

### Kontakti me botën e jashtme

66. Legjislacioni në fuqi<sup>30</sup>, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korresponcencë (që u nënshtrohen përfjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe për vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përvèç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë thirrje telefonike. Bazuar në intervistat me të dënuarit, atyre u mundësohen dy vizita në muaj dhe një vizitë shëtesë, sipas kërkesës së parashtruar në Drejtori.

67. Lidhur me thirrjet telefonike, Udhëzimi Administrativ përf Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>31</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë për biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjera. Sipas këtij udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 minuta.

68. Të dënuarit në regjim themelor mund t’i lejohet një telefonatë gjatë javës, e cila zgjat 15 minuta, ndërsa të dënuarve në regjim të avancuar mund t’u lejohen dy thirrje telefonike, të cilat zgjasin 15 minuta.

69. Në rastin e të paraburgosurve, nen 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufive të rregullave të qendrës së paraburgimit*” bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, kodi përcakton se korresponca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Bazuar në intervistat me të paraburgosurit,

<sup>28</sup> Komiteti Evropian përf Parandalimin e Torturës, në raportin përf vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka kërkuar nga autoritetet relevante që të ndërpritet praktika e kërkesës përf vërtetim nga mjeku se i paraburgosuri apo i dënuari është në gjendje përf ta përballuar masën.

<sup>29</sup> Neni 107 i Ligjit përf Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nen 76 i Udhëzimit Administrativ përf Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

<sup>30</sup> Ligji përf Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 62-65.

<sup>31</sup> Udhëzimi Administrativ përf Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, nen 54.

del se atyre u mundësohen dy vizita në muaj sipas lejes së gjykatës dhe një vizitë shtesë nga Drejtoria, bazuar në kërkesën e parashtruar nga i paraburgosuri në rrethana të caktuara.

70. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, të gjyqtarit të vetëm gjykues apo të kryetarit të trupit gjykues ose të personave të tjera të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit. Po ashtu, të dënuarit mund t'i drejtohen MKPT-së së Avokatit të Popullit edhe përmes telefonit.
71. Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që, me shkrim ose me gojë, të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike, apo me zyrën përkatëse të shtetit shtetësinë e të cilat e ka ai/ajo.<sup>32</sup> Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar një shtetas të huaj, i cili nuk pati asnjë ankesë sa i përket trajtimit nga zyrtarët korrektues dhe marrëdhëniet me të burgosurit e tjerë. Përkundrazi, ai u shpreh në favor të marrëdhënieve mjaft pozitive, si me zyrtarët korrektues, ashtu edhe me të burgosurit tjerë.

### Hapësirat ku pranohen vizitat

72. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vizituar edhe hapësirat ku pranohen vizitat familjare në pavijonin D. Kushtet në këto hapësira mbeten në nivel të kënaqshëm dhe nuk ka bariera, të cilat do ta pengonin kontaktin e drejtpërdrejtë ndërmjet familjarëve dhe të të burgosurit. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa as nga të burgosurit dhe as nga vizitorët, të cilët, gjatë vizitës, gjendeshin në këto hapësira.

### Procedurat e pranimit

73. Në QKD, të sapo pranuarit u nënshtronen procedurave të pranimit, të cilat zgjasin më së shumti deri 30 ditë. Gjatë kësaj periudhe, ata vlerësohen dhe kategorizohen nëpër qeli të veçanta, para se të akomodohen nëpër qeli të zakonshme. Për shkak të rinovimeve, tash për tash, ata vendosen në njërin krah të pavijonit 5. Sa i përket kontakteve me botën e jashtme dhe shëtitjeve gjatë kësaj periudhe, të burgosurit deklaruan se u lejohen dy thirrje telefonike dhe dy vizita gjatë periudhës sa ata janë të vendosur në këtë pavijon. MKPT-ja nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit lidhur me të drejtat e tyre në këtë fazë të vuajtjes së dënimit.

### Çështje të ndërlidhura me sigurinë

74. Edhe gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se i ashtuquajturi *peper spray* edhe më tej është pjesë e pajisjeve të zyrtarëve të caktuar korrektues në QKD. Përveç kësaj, MKPT-ja sërisht është njoftuar se ky *peper spray* është me afat të skaduar.
75. MKPT-ja është njoftuar nga Drejtoria se, në disa pavijone dhe objekte në QKD-së, nuk ka kamera të sigurisë, si dhe disa kamera janë jashtë funksionit. Mirëpo, në disa pavijone janë instaluar kamëra të sigurisë me rezolucion HD dhe janë të tipit rrotullues, të cilat

<sup>32</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nen 33, paragrafi 1.

ofrojnë pamje të kualitetit të lartë. MKPT-ja mirëpret këtë zhvillim. Përndryshe, situata në pavijonet tjera mbetet përgjithësisht e njëjtë, si dhe gjendja e konstatuar gjatë vizitës së realizuar në mars të vitit 2018. MKPT-ja përsëri inkurajon autoritetet e QKD-së që t'i pajisin me kamera të sigurisë të gjitha korridoret e pavijoneve dhe të hapësirave të jashtme, të cilat, sipas KPT-së, në fakt përbëjnë një nga garancitë përmbrojtje nga keqtrajtimi, por përbëjnë edhe garanci përmbytje korrektues kur ata akuzohen rrejshëm.<sup>33</sup>

### **Incidentet ndërmjet të të burgosurve**

76. Bazuar në dokumentacionin relevant, MKPT-ja ka vërejtur se gjatë këtij viti e deri më tani janë regjistruar 12 incidente ndërmjet të të burgosurve. MKPT-ja ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës, sipas nevojës është ofruar ndihma mjekësore dhe janë ndërmarrë veprimet e parapara me Ligjin përmbytje Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

### **Procedurat e ankesave**

77. Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi përmbytje të parashtruar ankesë brenda burgut apo përmbytje të parashtruar ankesë qendrës së paraburgimit ku është vendosur dhe në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.
78. Neni 91 i Ligjit përmbytje Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo me lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshinë edhe afatet përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe Ministria e Drejtësisë.<sup>34</sup>
79. MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve në QKD janë kutitë e ankesave, të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, nga DShB-ja dhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që përmbytje ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.
80. MKPT-ja, përmbytje dallim nga viti i kaluar, nuk ka marrë ankesa nga të burgosurit përgjigje në ankesat apo në kërkesat e parashtruara.

<sup>33</sup> KPT-ja, raporti përmbytje vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18.

<sup>34</sup> Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit përmbytje Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: "Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formë me shkrim."

Në bazë të të gjeturave dhe të konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon

Ministrisë së Drejtësisë:

1. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të miratohet legjislacioni sekondar përluftimin e korruptionit, siç parashihet me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
2. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të bëhen rrinovimet e nevojshme në pavijonin 8.
3. Të furnizohet kuzhina me pajisje adekuate sipas vlerësimit konkret.
4. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të ndërmerren hapa konkretë në mënyrë që të ndërpritet praktika e përdorimit të pajisjeve të improvizuara elektrike.
5. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të burgosurit të furnizohen me dollapë përvendosjen e gjësendeve të tyre.
6. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin përfunksionalizimin e sallës së sportit.
7. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin përfunksionalizimin e njësisë ekonomike.
8. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që në spitalin e burgut të gjendet zgjidhje adekuate përtë ofruar qasje adekuate përpacientët me aftësi të kufizuara në katin e dytë të spitalit.
9. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues, sipas vlerësimit të nevojave.
10. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të vendosen kamerat e sigurisë aty ku mungojnë.
11. MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të shtohet numri i punëtorëve socialë, bazuar në numrin e të burgosurve në QKD.
12. Të adresohen nevojat e zyrtarëve korrektues sa u përket kushteve të punës dhe shqetësimëve për statusin e tyre që ndërlidhet me Ligjin për Pagat.
13. Të hiqet nga përdorimi *peper spray* me afat të skaduar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të*

*përmبajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.*

Me nederime,



Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit